



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1335 prot.

Tiranë më, 08.09 2020

U R D H Ë R

Nr. 120, datë 08.09. 2020

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË “RREGULLOREN STANDARD TË
ORGANIZMIT DHE FUNKSIONIMIT TË PROKURORIVE TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM” MIRATUAR ME URDHËRIN NR.32
DATË 31.01.2017”**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronjat “c” dhe “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 38 pika 2, shkronja “e”, 20 e 21 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e disa shtesave në Rregulloren Standard “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm”, e miratuar me urdhërin nr.32 datë 31.01.2017 “Për miratimin e rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridikcionit të përgjithshëm”, sipas aneksit 1 bashkëlidhur.

2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm, miratojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, shtesat në rregulloret e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, duke e përshtatur me shtesat në rregulloren standard. Një kopje e rregullores me shtesat/ndryshimet e miratuarë dhe aktet e nxjerra në zbatim të saj të dërgohet brenda 3 (tre) ditëve në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikcion të përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN CELA



DISA SHTESA

NË

RREGULLOREN STANDARDE

**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË ME
JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM”**

Me synim përmirësimin e rregullave standard në organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikson të përgjithshëm dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit në organizimin dhe funksionimin e seksioneve të prokurorive në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;

Në Rregulloren Standarte “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikson të përgjithshëm”, të miratuar me urdhërin nr.32 datë 31.01.2017 “Për miratimin e rregullores standarte të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksonit të përgjithshëm”, bëhen disa shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 18 “Sekcionet e prokurorisë” pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4, 5 dhe 6, me këtë përbajtje:

“3. Seksioni/et në prokurori dhe përbërja e tij/tyre duhet të kenë qëndrueshmëri në veprimtarinë që kryejnë në prokuroritë e organizuara mbi bazë sektionesh.

a) Çdo fillim viti, por jo më vonë se fundi i muajit janar, përvèç rasteve kur krijimi i sektioneve të reja bëhet mbi bazën e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, mbështetur vetëm në kriteret e parashikuara në ligj dhe në pikën 1 të këtij neni, drejtuesi i prokurorisë mund të vendosë krijimin ose suprimimin e një sezioni, shtimin apo pakësimin e kategorive të veprave penale apo subjekteve të kryerjes së tyre tek një sezioni, transferimin e prokurorëve ose të oficerëve të policisë gjyqësore nga njëri sektion në tjetrin.

4. Në lëvizjen e prokurorëve në sektionë tjetra mbahen parasysh këto kritere:

a) Një prokuror duhet të ushtrojë funksionet në një sektion për jo më pak se 4 (katër) vjet, por jo më gjatë se 7 (shtatë) vite të njëpasnjëshme, përvèç rasteve kur për shkak të specializimit të veçantë të prokurorit në atë fushë, do të ulej cilësia e punës në

seksion. Në çdo rast, me përfundimin e shtatë viteve, ky prokuror mund të kërkojë transferimin në një seksion tjetër.

b) Lëvizja e prokurorit në një seksion ekzistues mund të bëhet vetëm nëse seksioni ku do të transferohet ka rritje të ngarkesës së punës gjatë gjithë vitit kalendarik në masën mbi 30% në raport me vitin paraardhës.

c) Prokurori që do të transferohet në një seksion të ri apo seksion ekzistues duhet të jetë prokurori me ngarkesën më të vogël të punës në seksionin ku ushtron funksionet ose të ketë specializim përkatës pér kategorinë e veprave penale që do të ndjek seksioni ku do të transferohet. Në çdo rast, prokurori nuk mund të përzgjidhet nga një seksion ku transferimi do të sjellë rritje mbi 30% të ngarkesës pér prokurorët në atë seksion.

ç) Transferimi i prokurorit nga një seksion në një tjetër seksion nuk përbën shkak pér zëvendësimin e tij lidhur me çështjet/procedimet që ai ka në ndjekje, pér të cilat vijon ushtrimin e ndjekjes penale dhe/ose përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykim.

5. Përzgjedhja dhe emërimi i drejtuesit të seksionit/eve kryhet vetëm mbështetur në kushtet dhe kriteret e parashikuar në ligj¹ dhe në këtë rregullore.

Neni 2

Në nenin 20 “Drejtuesi i seksionit”, pas pikës 1 shtohen një paragraf me këtë përbajtje:

“Drejtuesi i prokurorisë nuk mund të jetë edhe drejtues i një seksioni dhe/ose nuk mund të ushtroj funksionet në cilësinë/emër të tij. Në raste të vakancës së përkohshme, drejtuesi i seksionit zëvendësohet përkohësisht me vendim/urdhër të drejtuesit të prokurorisë nga një prokuror tjetër i të njëjtit seksion.”

Neni 3

Pas nenin 47 shtohet neni 48, dhe nenet 48 e 49 të ndryshuar numërtohen nenet 49 e 50 me këtë përbajtje:

“Neni 48

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë rregullore standate dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit² dhe shkak pér të kërkuar fillimin e inspektimit dhe/ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit përkatës të prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm.”

“Neni 49

¹ Shih, nenin 21 “Seksionet e prokurorive” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në pika 2, parashikon: “2. Drejtuesi i seksionit emërohet nga drejtuesi i prokurorisë nga radhët e prokurorëve të seksionit, të cilët kanë të paktën 5 vjet përvojë si prokurorë, rezultate të mira në punë dhe aftësi organizative.”

² Shih, nenin 101 pika 1 shkronja “a”, “b” dhe nenin 102 pika 1 shkronjat “g” “j”, “l” dhe pika 2 shkronjat “ç”, “d” e vijues të ligjit nr.96/2016 i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019.

Dispozita kalimtare

1. Çdo akt nënligjor që rregullon çështjet e brendshme në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____ dhe që bie ndesh me ligjin dhe dispozitat e kësaj rregullore, shfuqizohet.

2. Drejtuesit e prokurorive brenda 5 ditësh nga shfuqizimi i aktit nënligjor marrin masat e duhura organizative dhe ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë çështjet e brendshme në prokurori dhe/ose organizimin e drejtimin e seksioneve në zbatim të ligjit dhe dispozitave të kësaj rregullore.

3. Deri në krijimin e faqeve të internetit të prokurorive pranë gjykatave me juridiksim të përgjithshëm, udhëzimet e përgjithshme të drejtuesve të prokurorisë dhe aktet e tjera administrative që ligji parashikon publikimin e tyre, dërgohen në Prokurorinë e Përgjithshme për t'u publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.”

“Neni 50

Hyrja në fuqi

Shtesat në rregulloren statndard hyjnë në fuqi menjëherë.”